VENDIM
Nr. 587, datë 18.10.2017

PËR NJË SHTESË FONDI
NË BUXHETIN E VITIT 2017, MIRATUAR PËR KONTROLLIN E LARTË TË SHTETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe të nenit 13, të ligjit nr. 130/2016, "Për buxhetin e vitit 2017", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kontrollit të Lartë të Shtetit, në buxhetin e miratuar për vitin 2017, i shtohet fondi prej 11 700 000 (njëmbëdhjetë milionë e shtatëqind mijë) lekësh, zëri "Shpenzime kapitale, me financim të brendshëm", për projektin "Rikonstruksion godine i KLSH-së".
2. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, i miratuar për vitin 2017.
3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi